
FORMULAR REGJISTRIMI

EMRI I SUBJEKTIT: _____

NIPT / ID: _____

PËRFAQËSUESI: _____

EMAIL: _____

TELEFON: _____

ADRESA: _____

QYTETI: _____

TIRANË ___ / ___ / 2022

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT NGA POSTAL Delivery & Logistics

Për dërgimin e dokumentave, pakove dhe porosive të ndryshme nëpërmjet **POSTAL Delivery & Logistics**, dërguesi është i detyruar të plotësojë këtë formular duke pranuar të gjitha kushtet, të drejtat, detyrimet dhe penalitetet që përmenden në të. Asnjëra nga palët, pra as dërguesi dhe as ofruesi i shërbimit apo përfaqësues të tyre nuk kanë të drejtë të bëjnë asnjë ndryshim në kushtet e përshkruara më poshtë, pa arritur paraprakisht një marrëveshje me shkrim mes palëve e cila pas firmosjes nga të dyja palët i bashkangjitet formularit të firmosur që në fillimin e ofrimit të shërbimit.

- Formulari shoqërues i dërgesës është i panegociueshëm dhe dërguesi ka dijeni se ky formular është plotësuar nga ai ose nga POSTAL Delivery & Logistics për llogari të tij.
Dërguesi deklaron dhe pranon, se është pronar, posedues ose përfaqësues i pronarit apo i poseduesit të objekteve që transportohen, të cilat përshkruhen në faqen e parë.
Gjithashtu, ai deklaron se me anën e këtij formulari pranon kushtet e transportit të POSTAL Delivery & Logistics.
- Dërguesi garanton që:
 - Çdo zë në faqen e parë të formularit shoqërues të dërgesës përshkruhet saktësisht dhe në përputhje me ligjin.
 - Në objektin që dërgohet janë shënuar saktësisht të dhënat dhe adresa e marrësit.
 - Objekti që dërgohet është ambalazhuar në mënyrë që të sigurohet dërgimi i sigurtë i tij.
 - Dërgesa nuk përmban asgjë të ndaluar apo të jashtëligjshme.
 - Do të paguajë të gjitha shpenzimet shtesë, që rezultojnë gjatë dërgimit, kthimit ose magazinimit të objekteve.
- POSTAL Delivery & Logistics nuk mban asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e dërgesës pasi nuk është në gjendje të verifikojë përmbajtjen e çdo dërgese.
Çdo përgjegjësi për përmbajtjen e dërgesës bie mbi dërguesin i cili është i informuar për produktet dhe substancat që janë të ndaluara të dërgohen nëpërmjet shërbimit postar të ofruar nga POSTAL Delivery & Logistics.
Në rast konstatimi të përmbajtjes së ndaluar, POSTAL Delivery & Logistics ka të drejtën të njoftojë organet kompetente dhe t'ju ofrojë atyre të gjitha të dhënat që disponon në lidhje me dërgesën dhe dërguesin e saj.
- POSTAL Delivery & Logistics ka të drejtë, por nuk detyrohet të kontrollojë objektin që merr përsipër ta dorëzojë.
POSTAL Delivery & Logistics, gjithashtu, ka të drejtë të mos e realizojë dërgesën nëse ka shenja të përmbajtjes së ndaluar ose të dhëna të pamjaftueshme të marrësit.
- Dërgesat nëpërmjet POSTAL Delivery & Logistics kryhen me debitim të marrësit, por në rast mospranimi të dërgesës apo shpërbilimit nga ana e marrësit, për çfardo arsye qoftë, dërguesi merr përsipër pagesën ndaj POSTAL Delivery & Logistics.
- POSTAL Delivery & Logistics ka të drejtë të mbajë ose të mos e dorëzojë mallin që transporton, me qëllim sigurimin e shpenzimeve të transportit deri sa të paguhet.
- POSTAL Delivery & Logistics bën të gjitha përpjekjet për të arritur dorëzimin sa më shpejt dhe në kushte optimale të të gjithë dërgesave, por në asnjë rast nuk mban përgjegjësi për vonesën e marrjes, transportimit ose dorëzimit apo për çfardo humbje, dëmtim apo mos dorëzim që vjen për shkak të paparashikuara:
 - për shkak të ngjarjeve të papritura që ndodhin objektivisht jashtë mundësive njerëzore (aksident, kushtet e këqija atmosferike, etj.).
 - për shkak të veprimeve neglizhuese të dërguesit, marrësit apo personave të tretë që kanë interes nga dërgesa konkrete.
 - për shkak të përmbajtjes së dërgesës së cilës mund t'i shkaktohet dëmtimi i veçantë, ndryshim ose shkatërrim.
- Përgjegjësia e POSTAL Delivery & Logistics për çdo humbje ose dëmtim, kufizohet në minimum nga sasitë e mëposhtme:
 - Në shumën reale të humbjes ose dëmit që paguhet për dokumente, ose objekte të siguruar.
 - Në **vlërën reale*** të dokumenteve ose objekteve, pa u marrë parasysh përdorimi tregtar ose vlera e veçantë e tyre për dërguesin, marrësin ose personin e tretë.
***Vlera reale konsiderohet:**
 - për dokumenta kostoja e përgatitjes, zëvendësimit, riprodhimit apo e rihartimit të tyre.
 - për objektet – kostoja e riparimit, zëvendësimit ose blerjes së tyre.Sa thamë më sipër vlejën edhe për dërgesat me vlerë të deklaruar kur janë të siguruar.
- Çdo pretendim për dëmtim, humbje, vonesë, etj, duhet të dorëzohet me shkrim në zyrat e POSTAL Delivery & Logistics.